



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18853 Prot.

Lezhë, më 01 . 11 . 2021

VENDIM

Nr. 151 Datë 28 . 10 . 2021

PËR
FALJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA PËR KATEGORITË E
TAKSAPAGUESVE “FAMILJARË”, “BIZNES” DHE “INSTITUCIONE,
PËR ZËRIN “TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1/1.3, germa “b”, neni 35, pika 4 dhe 5, neni 54, germa “f”, ne Ligjin nr.9632 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 5, germa “c”, neni 35, pika 2, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Të përfitojnë lehtësi fiskale duke falur dhe zbritur detyrimet për zërin e “**Tarifës së Shërbimeve Publike**” për të gjithë kategoritë e taksapaguesve “**Familjarë**”, “**Biznes**” dhe “**Institucione**” në rastet, si më poshtë :
 - a. Të falen të gjithë detyrimet e prapambetura përpara vitit 2021, për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Familjarë**”, të cilët kanë detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifave vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet e prapambetura, për zërin e taksës mbi pasurinë për periudhën e kaluar dhe detyrimet e vitit korent, përfshirë këtu edhe zërin e tarifës së shërbimeve publike, brenda vitit 2021.
 - b. Të bëhet zbritje me 50(pesëdhjetë) %, e të gjithë vlerës së detyrimeve për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Familjarë**”, të cilët **nuk kanë** detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifave vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet vjetore për vitin korent, brenda vitit 2021.
 - c. Të falen të gjithë detyrimet e prapambetura përpara vitit 2021 për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Biznes**”, të cilët kanë detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifave vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet e prapambetura për zërat e tjerë të taksave dhe tarifave vendore, për periudhën e kaluar dhe detyrimet e vitit korent, përfshirë këtu edhe zërin e tarifës së shërbimeve publike, brenda vitit 2021.
 - d. Të bëhet zbritje me 50(pesëdhjetë) %, e të gjithë vlerës së detyrimeve për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Biznes**”, të cilët **nuk kanë** detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifave vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet vjetore, për zërat e tjerë të taksave dhe tarifave vendore, brenda vitit 2021.
 - e. Të falen të gjithë detyrimet e prapambetura përpara vitit 2021, për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e

taksapaguesve “**Institucione**”, të cilët kanë detyrime të prapambetura të palikujduara, për tarifatat vendore, nëse ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet e detyrimet e vitit korent për zërin e tarifës së shërbimeve publike, brenda vitit 2021.

- f. Në faljet dhe përfitimet e sipërcituara përfshihen edhe kamatvonesat, vetëm për zërin e tarifës së shërbimeve publike.
2. Të gjithë kategoritë e taksapaguesve, të cilët nuk kryejnë pagesën për detyrimet, konform dhe brenda afateve, të cituar në pikën 1 të këtij vendimi, detyrimet e tyre për zërin “Tarifa e shërbimeve publike”, ngelin në fuqi konform VKB nr.46, datë 13.11.2019.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë, Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

